

## **2012 Raporti i Departamentit të Shtetit Mbi Trafikimin e Qënieve Njerëzore (20 Qershor 2012)**

### **Shqipëria (Grupi 2)**

Shqipëria është kryesisht vend burimi për burra, gra dhe fëmijë që bëhen pre e trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe për punë të detyruar, përfshirë edhe lypjen me detyrim për fëmijët. Ka akoma gra dhe fëmijë shqiptarë që janë objekt trafikimi me qëllim shfrytëzimin seksual brenda vendit. Viktimat shqiptare u nënshtrohen kushteve të punës së detyruar dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin seksual në Greqi, Itali, Maqedoni, Kosovë, Serbi dhe në gjithë Europën Perëndimore. Autoritetet kanë raportuar gjetjen e viktimave të trafikimit nga Greqia dhe Ukraina në Shqipëri gjatë këtij viti. Fëmijët shfrytëzoheshin për qëllime seksuale, lypje me forcë dhe akte kriminale të detyruara, si për shembull grabitje dhe shpërndarje droge. Vajzat gjithashtu kanë qenë objekt prostitucioni apo pune të detyruar pas martesave me mblesëri. Ka të dhëna se burra shqiptarë i nënshtrohen punës së detyruar në bujqësi në Greqi dhe vende të tjera fqinje. Ritrafikimi i viktimave shqiptare vazhdoi të ishte problem.

Qeveria e Shqipërisë nuk i përmbush plotësisht standardet minimale për zhdukjen e trafikimit. Megjithatë, po bëhen përpjekje domethënëse për ta realizuar këtë gjë. Gjatë vitit qeveria rriti kapacitetet për të identifikuar paraprakisht viktimat e trafikimit, përdori programin e mbrojtjes së dëshmitarëve për të mbrojtur viktimat e trafikimit dhe siguroi fonde afatshkurtra për OJQ-të me qëllim mbrojtjen e viktimave. Megjithatë, mungesa e përgjithshme e fondeve të qëndrueshme për OJQ-të kundër trafikimit të personave çoi në mbylljen e përkohshme të një qendre rehabilitimi gjatë vitit, duke krijuar kështu një ndikim negativ në ndihmesën e viktimave. Për më tepër, korrupsioni i përhapur, në veçanti në sektorin gjyqësor, vazhdoi të pengonte përpjekjet e përgjithshme kundër trafikimit.

Rekomandimet për Shqipërinë: Të zbatojë paraprakisht procedurat e reja standarde për identifikimin e viktimave me qëllim rritjen e gamës së viktimave të identifikuar në Shqipëri; të sigurojë fonde të mjaftueshme për OJQ-të që japin ndihmë jetike për viktimat; të sigurojë qasje me viktimmën në fokus me qëllim identifikimin e viktimave duke mos vënë si kusht për të siguruar statusin e viktimmës rolin e tyre në hetimet penale; të zgjerojë fokusin e kujdesit për të siguruar më shumë shërbime për komunitetin gjatë riintegrit të viktimave dhe për të fuqizuar të mbijetuarit, të ndihmojë në zbutjen e përbuzjes që lidhet me trafikimin; të vazhdojë të marrë masa për rritjen e mbrojtjes së dëshmitarit-viktimmë për viktimat që janë gati të bashkëpunojnë në zbatimin e ligjit; të ndjekë më fuqishëm rastet e trafikimit që ndodhin brenda vendit; dhe të hetojë paraprakisht bashkëpunimin e zyrtarëve qeveritarë në lidhje me trafikimin.

### **Ndjekja penale**

Qeveria e Shqipërisë vazhdoi përpjekjet e saj për zbatimin e ligjit kundër trafikimit gjatë vitit të kaluar, megjithëse dënoi më pak trafikantë krahasuar me një vit më parë. Shqipëria e dënon me ligj trafikimin për prostitucion dhe punë të detyruar sipas neneve 110(a), 128(b), dhe 114(b) të kodit penal, të cilët përshkruajnë dënime që variojnë nga pesë deri në 15 vite heqje lirie. Këto dënime janë tejet të rrepta dhe i kalojnë ato të parashikuarat për krime të tjera të rënda, si për shembull përdhunimi. Prokuroria e Krimeve të Rënda raportoi se kishte hetuar 27 të dyshuar për trafikim të qenieve njerëzore në vitin 2011, krahasuar me 29 të dyshuar që u hetuan gjatë vitit 2010. Gjatë vitit të kaluar, Gjykata e Krimeve të Rënda ndoqi penalisht pesë të dyshuar për trafikim; të pestë rastet rezultuan në dënime në vitin 2011, krahasuar me 11 dënime gjatë vitit 2010. Dënimet e dhëna për pesë trafikantët variuan nga gjoba deri në 15 vite heqje lirie. Qeveria

vazhdoi hetimet në lidhje me një rast trafikimi për punë të detyruar nisur në vitin 2010, por akoma nuk ka ngritur akuza zyrtarisht për ndonjë të dyshuar. OJQ-të përgëzuan reagimin e ndjeshëm ndaj viktimave nga ana e prokurorëve të caktuar për çështjet e trafikimit gjatë vitit, përfshirë edhe dërgimin nga ana e tyre të viktimave për kujdes të mëtejshëm. Sipas një raporti të vitit 2011 mbi Shqipërinë nxjerrë nga Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Europës mbi veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA), njohja zyrtare nga ana e qeverisë shqiptare e nevojës për të rritur reagimin ndaj trafikimit të brendshëm ende nuk ka çuar në masa konkrete. Korrupsioni i përhapur në të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë shqiptare vazhdoi të ndikonte seriozisht aftësinë e qeverisë për të shqyrtuar e zgjidhur problemin e trafikimit të qenieve njerëzore. Gjatë vitit 2011 qeveria nuk ka raportuar të ketë marrë ndonjë masë zbatimi ligji ndaj bashkëpunimit në trafikim.

### **Mbrojtja**

Qeveria e Shqipërisë avancoi dukshëm në fuqizimin e kapacitetit për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit në vitin 2011. Mungesa e fondeve të qëndrueshme të qeverisë për OJQ-të rezultoi në mbylljen e përkohshme të një qendre gjatë periudhës së raportimit. Vitin e kaluar, qeveria raportoi identifikimin e 84 viktimave të reja të trafikimit nëpërmjet mekanizmit kombëtar të referimit, krahasuar me 97 viktima të identifikuar në vitin 2010. OJQ-të raportuan se kishin ndihmuar 132 viktima të trafikimit gjatë vitit. Në korrik të vitit 2011 qeveria aprovoi procedurat standarde të veprimit përqendruar te viktima në bashkëpunim me shoqërinë civile për të përmirësuar identifikimin e viktimave dhe dërgimin e tyre në qendrat e kujdesit. Megjithëse procedurat standarde të veprimit e ndanë statusin e viktimave të trafikimit nga gatishmëria e tyre për të vendosur akuza kundër trafikuesve të tyre, OJQ-të vërejtën raste në të cilat policia dhe punonjësit socialë garantuan status viktime vetëm pasi viktimat kishin pranuar marrëveshjen për të marrë pjesë formalisht në procedurat kundër trafikuesve të tyre.

Për herë të parë qeveria shqiptare u dha fonde OJQ-ve për të siguruar shërbime strehimi për viktimat e trafikimit, shumë e cila arriti në përafërsisht 9775 dollarë për tre OJQ. Qeveria e përfundoi politikën e mëparshme të kërkesës për të patur praninë e punonjësve socialë shtetërorë gjatë intervistave për identifikimin e viktimave të bëra nga OJQ-të si parakusht për dhënie fondesh. Fondet e dhëna për OJQ-të ishin të kufizuara vetëm në shpenzime për ushqime; disa viktimave të mundshme trafikimi që kishin nevojë për këtë përfitim nuk iu dha. Për shkak të mungesës së fondeve të qëndrueshme, një prej këtyre OJQ-ve u detyrua të mbyllte qendrën përkohësisht gjatë vitit, duke hequr kështu ndihmën për viktimat në një zonë të vendit me nevojë të madhe për shërbime të tilla. Megjithatë, qeveria vazhdoi të jepte fonde dhe të mbante në aktivitet një qendër pritjeje që strehonte si viktimat e trafikimit edhe emigrantë të huaj pa dokumenta, por shpesh liria e lëvizjes së viktimave kufizohej në këtë qendër. Për më tepër, qendra nuk kishte kapacitet për të siguruar ndihmë të përgjithshme riintegrimi për viktimat. Disa OJQ raportuan preferencë nga ana e zyrtarëve për t'i drejtuar viktimat e trafikimit në qendrën e pritjes më mirë se sa në qendrat e OJQ-ve; më shumë se gjysma e gjithë viktimave të identifikuar rishtazi në vitin 2011 morën ndihmë në këtë qendër. Qeveria nuk i dënoi viktimat e identifikuar për veprimet e paligjshme që kishin kryer në lidhje me trafikimin e tyre; megjithatë, kodi penal i Shqipërisë aktualisht nuk e ndalon këtë gjë. Ekspertët në vend shprehën shqetësimin se policia lokale nuk njihnte trafikimin e fëmijëve brenda vendit dhe i trajtonte rastet e tilla si “shfrytëzim për prostitucion” ose “keqtrajtim fëmijësh”. Ligji kundër trafikimit në Shqipëri siguron lehtësim të procesit të emigracionit si alternative ndaj kthimit të viktimave të huaja në vendet e tyre në rastet kur ato mund të hasin vështirësi ose ndëshkim, megjithëse qeveria nuk ka ofruar diçka të tillë për asnjë viktimë gjatë vitit 2011. Qeveria inkurajoi viktimat të merrnin pjesë

në hetime dhe ndjekje penale të trafikuesve. Viktimat të cilat ndonjë çështjet kundër trafikuesve të tyre vazhduan të ishin në rrezik ndëshkimi dhe shpesh pati nevojë për mbrojtje dëshmitari pas nisjes së procesit gjyqësor. Gjatë vitit, 28 viktima të trafikimit ndihmuan personat përgjegjës për zbatimin e ligjit në fazën e hetimit dhe dy viktima trafikimi dëshmuan gjatë gjyqit. Në një rast qeveria regjistroi një prej këtyre viktimave në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve. Qeveria raportoi të ketë siguruar ndihmë financiare për pesë viktima të trafikimit për të ndihmuar në procesin e riintegrit të tyre pasi u larguan nga qendra. Qeveria kreu katër trajnime për zbatimin e ligjit edhe për reagime të tjera fillestare në lidhje me procedurat e aprovuara rishtaz për identifikimin dhe referimin e viktimave gjatë vitit 2011.

### **Parandalimi**

Shqipëria vazhdoi me përpjekjet për parandalimin e trafikimit të personave gjatë vitit, megjithëse kryesisht mbështetej te donatorët ndërkombëtarë për sigurimin e fondeve për fushatat e ndërgjegjësimit kundër trafikimit. Qeveria vazhdoi të monitoronte përpjekjet e saj kundër trafikimit nëpërmjet zyrës së koordinatorit kombëtar për luftën kundër trafikimit, e cila ndihmoi në hapjen e fushatës kombëtare me fonde donatorësh në vitin 2011 me titull “Fëmijëria nuk është shfrytëzim për punë”. Kjo fushatë kishte në vëmendje shkollat dhe fëmijët në rrezik për të ndërgjegjësuar publikun dhe mësuesit në lidhje me punën e detyruar. Gjatë vitit zyra e koordinatorit kombëtar ndër morri hapa për lehtësimin e regjistrimit të fëmijëve të pargjistruar të cilët ishin më të prekurit nga trafikimi në Shqipëri. Qeveria vazhdoi të financonte linjën telefonike falas me shërbim 24 orësh për viktimat dhe viktimat e mundshme për trafikim. Qeveria nuk bëri përpjekje të dukshme për të marrë masa kundër kërkesës për veprime shfrytëzimi seksual me qëllim përfitimi.

###